

---

**OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA SH.A**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË  
MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E  
ANKIMIMIT**

[Data 28.01.2025]

**Drejtuar: Operatorit Ekonomik (OE)** “KLAME” shpk me NIPT: K21518003F  
Adresa: Tiranë, Njësia Administrative 11, Kodër Kamëz, Rruga Gani Kryeziu, Nr.23, Kati I,

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)**

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

**- OE/BOE me nënkontraktor**

**PO**  **JO**

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

**-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**

**PO**  **JO**

Nëse po, të jepen dhënat: \_\_\_\_\_

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

\* \* \*

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur, mbi kufirin e lartë monetar, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-29865-11-18-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Objekti: “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim”, ku janë përfshirë kërkesat e dy Autoriteteve Kontraktore përfituese. Marrëveshje kuadër me fond limit total 55,000,038 (pesëdhjetë e pesë milion e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH dhe 560,253 (pesëqind e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) Euro pa TVSH. Afati i marreveshjes kuadër deri në 36 muaj, sipas AK - Për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit afati i marreveshjes kuadër 36 muaj dhe afati i lëvrimit të mallit 90 (nëntëdhjetë)ditë nga data e nënshkrimit të kontratës përkatëse. - Për Ministrinë e Financave afati

i marrëveshjes kuadër 12 muaj dhe afati i lëvrimit të mallit 30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës përkatëse.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 19.11.2024

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 81 datë 25 Nëntor 2024

### KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse, si më poshtë:

1. "M. LEZHA" shpk  
Emri i plotë i shoqërisë

NIPT: J76504013C  
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 44, 055, 000 (dyzetë e katër milion e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH  
(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. "RO -AL" shpk  
Emri i plotë i shoqërisë

NIPT: J61811001M  
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 30, 255, 500 (tridhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH  
(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. "BOLT" shpk  
Emri i plotë i shoqërisë

NIPT: K91517011V  
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 41,264,100 (dyzetë e një milion e dyqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind) lekë pa TVSH  
(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

4. "BUNA" shpk

NIPT: J61826501C

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 39, 571, 200 (tridhjetë e nëntë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e një mijë e dyqind) lekë pa TVSH

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

5. "ERALD" shpk

NIPT: J74517205P,

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 38, 592, 000 (tridhjetë e tetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

6. "ERZENI/SH" shpk

NIPT: J66902027T

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 32,364, 130 (tridhjetë e dy milion e trëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e njëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH

*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

7. "KLAME" shpk

NIPT: K21518003F

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 33, 944, 100 (tridhjetë e tre milion e nëntëqind e dyzetë e katër mijë e njëqind) lekë pa TVSH

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

8. “SHAGA.” shpk  
Emri i plotë i shoqërisë

NIPT: J96822229J  
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 31,187,200, (tridhjetë e një milion e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) lekë pa TVSH

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

9. “URBAN FURNITURE” shpk  
Emri i plotë i shoqërisë

NIPT: L74605203N  
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 34, 885, 975 (tridhjetë e katër milion e tetëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

#### **Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:**

1. “ERZENI/SH” shpk

NIPT: J66902027T

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

#### **Arsyet e skualifikimit:**

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit provues të dorëzuar nga operatori ekonomik, në lidhje me përmbushjen e kriterit 2.3.2 të DST, rezulton se OE ka paraqitur dokumentacionin lidhur me punonjësit sipas profileve të kërkuara në DST:

- A. K, me profesion marangoz, me deshmi profesionale të lëshuara nga subjekti A.....;
- F. A, me profesion marangoz, me deshmi profesionale të lëshuara nga subjekti A.....;
- S. T, me profesion marangoz, me deshmi profesionale të lëshuara nga subjekti A.....;
- A. B, me profesion bojaxhi, me deshmi profesionale të lëshuara nga subjekti A.....;
- A. U, me profesion bojaxhi, me deshmi profesionale të lëshuara nga subjekti A.....;

Lidhur me këto certifikata, KVO verifikoi në QKB dhe rezultoi se kjo shoqëri nuk ka asnjë licencë aktive dhe për rrjedhojë nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (publike apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh”.

Pra rezultoi se dokumentat e paraqitura për profesionet e punonjësëve të sipercituar (bojaxhi & marangoz), në zbatim të pikës 2.3.2 nuk përmbushin kërkesën e autoritetit kontraktor për “diplomë/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, pasi shoqëria ASQCERT, e cila ka lëshuar dëshmitë profesionale, nuk është licensuar nga ana Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe nuk disponon asnjë license për të ofruar kurse trajnimi për formimin profesional në përputhje me ligjin nr.15/2017, "Per arsimin dhe formimin profesional ne Republikën e Shqiperise.”

Formimi profesional i personelit përbën domosdoshmeri dhe garanton autoritetin kontraktor për kapacitetet profesionale të ofertesve për përmbushjen me sukses të kontratës, gjë e cila vërtetohet vetëm me Certifikatë/dëshmi/diplomë që është dokument zyrtar dhe i lëshuar një organ certifikues, sipas procedurave standarde ligjore dhe që regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit të caktuar.

Sa më sipër, operatori ekonomik “ERZENI/SH” shpk, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DST. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme:

Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.2. të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT për disponimin e stafit teknik me kualifikim arsimor nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

2. "RO -AL" shpk

NIPT: J61811001M

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave 30, 255, 500 (tridhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Arsyeja e skualifikimit:

Operatori ekonomik “RO-AL” shpk, me nipt: J61811001M ofertuar me vlerë 30, 255, 500 (tridhjetë milionë e dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) Lekë pa tvsh me dokumentacionin e paraqitur NUK përmbush kërkesat për kualifikim piken 2, 1, b) të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar në SPE konstatohet se OE nuk plotëson pike 2.1.b Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; Nga verifikimi i Formularit të sigurimit të ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “RO- AL” shpk konstatohet se sigurimi i nuk plotëson periudhën e vlefshërisë së ofertes prej 150 dite, pasi sigurimi ofertes së dorëzuar është lëshuar në datë 25.11.2024 dhe është i vlefshëm për 150

ditë. Referuar DT sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm për 150 ditë e perlojaritur duke filluar nga data e hapjes së ofertave pra duhet të fillonte me datë 30.12.2024 dhe të deklarohej i vlefshëm për 150 ditë nga kjo datë.

Sa më sipër operatori ekonomik ka paraqitur periudhë më të shkurtër vlefshmërie se periudha e kërkuar në DST. Oferta s'kualifikohet.

3. "SHAGA." shpk  
Emri i plotë i shoqërisë

NIPT: J96822229J  
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 31,187,200, (tridhjetë e një milion e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) lekë pa TVSH  
(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_  
(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

### Arsyeja e Skualifikimit

Operatori ekonomik "SHAGA" SHPK, me shkresën nr. 10 prot. date 15.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 2184/6 prot, datë 15.01.2025 ka dorëzuar pranë OBP dokumentacionin mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "SHAGA" SHPK, për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët të dorëzuar prej tij, e cila ka rezultuar anomalisht e ulët, KVO konstaton se:

➤ Struktura e kostos e argumentuar për artikujt objekt prokurimi me nr rendor. 1, 3, 4, 5, 7, 8, 9, 10, 25, 26, 27, 28, 29, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37 përbëhet nga elementët si në vijim: "Kosto e lëndës së parë (melamine, fiber, MDF, boje uji, llak transparent, katalik paste transparente, paste transparente, dylient, aceton, MDF shqeteo), kosto lenda ndihmese (amballazh telefoni, kartoni, kembe inoxi, vida, skoc, kolle, vinovil, etj) pagesa e punes, analiza e kostos dhe kosto te tjera.

Lidhur me argumentimin e kostos së lëndës së parë, kosto lenda ndihmese, KVO gjykon se dokumentacioni provues i paraqitur nga operatori ekonomik "SHAGA" SHPK vërteton koston e këtyre elementëve (mbeshtetur edhe në deklaratat doganore të dorëzuara nga operatori ekonomik me nr. R151201, date 24.12.2024, Nr. R79814 datë 10.07.2024 dhe fatura eleshuar nga "L. F" date 25.11.2024) ndërsa lidhur me vlerën e pagesë për amballazhim, pasqyruar në koston "Pagesa e punes" të përcaktuar për artikujt me nr. 1, 3, 4, 5, 7, 9, 10, 25, 26, 27, 28, 31, 32, 33, 34, 35, 37, KVO konstaton se vlera për "Pagesa e Punes" për këta artikuj është nën kufirin 200 lekë për orë pune (e cila varion: **100 lekë për artikujt** me nr. 1,5, 7, 26, 27, 28, 31 32, 33, 34 dhe 37; **50 lekë për artikujt** me nr. 3, 4, 9, 10, 25 dhe 41; **200 për artikujt** me nr. 35)

Lidhur me koston e orës së punës referuar pikës 3 të VKM nr. 113, datë 1.3.2023 "Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi", paga bazë minimale orare është 229.9 lekë, gjithashtu duke zbritur edhe sigurimet shoqërore përkatësisht 9.5% të pagës së tij totale bruto përcaktuar në nenin 10 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore Në Republikën E Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe sigurimet shëndetësore përkatësisht 1.7% referuar nenit 8 të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 "Për Sigurimin E Detyrueshëm Të Kujdesit Shëndetësor Në Republikën E Shqipërisë", I ndryshuar, rezulton se paga minimale neto është 204.15 lekë për orë pune.

➤ Në lidhje me struktura e kostos për argumentimin për artikujt objekt prokurimi me nr rendor. Nr. 2 "Dollap metalik me dyer" me vlerë 121,000 lekë pa tvsh; nr. 6 "Raft metalik për dosje (arshivë)" me vlerë 1,563,100 lekë pa tvsh; nr. 15 "Shtrat vizite për infermierin" me vlerë 169,400 lekë pa tvsh; nr. 42 "F+V Grila Roller" me vlerë 1,821,600 lekë pa tvsh operatori ekonomik nuk ka paraqitur prova shkresore mbi argumentin e kostos për këto zëra për t'i dhënë garanci edhe bindje KVO-se, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur në mënyrë të detajuar anën

ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose për kryerjen e punës.

Nisur nga sa më sipër KVO, gjykon se operatori ekonomik “SHAGA” SHPK, për artikujt Nr. 2, nr. 6, nr. 15 dhe nr. 42, ka dështuar në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët pasi nuk ka paraqitur në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit/procesit të prodhimit, ose të ketë paraqitur zgjidhje teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e artikujve të mësipërm, ndersa për artikujt me nr. 1, 3, 4, 5, 7, 9, 10, 25, 26, 27, 28, 31, 32, 33, 34, 35, 37, njëri nga elementët e kostos së përlogaritur prej tij dhe konkretisht pagesa e punës rezulton më e ulët se paga orare minimale e përcaktuar në pikën 3 të VKM nr. 113, datë 1.3.2023 “Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi”.

Gjithashtu, referuar nenit 93 pika 2/ç, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ku shprehet qartë se nuk mjafton vetëm të vërtetosh kostot e elementëve të ofertës por duhet edhe të jesh në përputhje me detyrimet që rrjedhin në fushën sociale dhe atë të punës, referuar kësaj operatori ekonomik “SHAGA” SHPK me pagën orare të deklaruar në analizën e ofertës anomalisht të ulët ka deklaruar paga në kundërshtim me VKM nr. 113, datë 1.3.2023 “Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi”.

Nga përlogaritjet tona, konstatojmë se oferta ekonomike, nuk ka zbatuar Vendimin e Keshillit të Ministrave nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Pra, shpjegimet dhe përlogaritjet e operatorit për ofertën anomalisht të ulët, nuk lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nga ku këto kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë veshtrim mjafton mosplotësimi i njerit prej tyre që operatori ekonomik të deshtojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndersa kushti i pestë lidhet me mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thote, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përben shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e këtyre kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të lex specialis gjë që nuk është rasti.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” operatori kishte barrën e provës dhe nuk e ka shkarkuar atë pasi ka argumentuar me detaje aritmetike ofertën anomalisht. Gjithashtu, argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet por nuk ka plotësuar këto kushte kumulative, për t’i dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori mund ta përmbushë me sukses kontratën.

Operatori ekonomik duhet por nuk ka dorezuar në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet por nuk ka paraqitur para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura, kushtet që ka për furnizimin e produkteve dhe shërbimeve, dhe për kryerjen e punës. Gjithashtu, nuk paraqitur prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ana e tij, duke mos paraqitur fatura blerje të mallrave me cmimet perkatese, oferta për mallra, cmimet e tregut, etj.

Operatori nuk ka vërtetuar nepermjet këtij sqarimi se ushtrone veprimtarinë në pajtueshmeri me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit duke mos paraqitur asnjë dokument që ka të bëjë me fushën sociale dhe të punës, si edhe se fundmi nuk ka argumentuar bazuar në Ligjin Nr.9374, datë 21.04.2005 “Per Ndihmën Shtetërore” (I ndryshuar me ligjin nr.10 183, datë 29.10.2009, nr. 21/2016, datë 10.3.2016, nr. 104/2018, datë 13.12.2018), se ky operator provon se ka mundësi për të përfituar ndihmë shtetërore nëse do të nevojitet, por aktualisht nuk ka nevojë për një ndihmë të tillë.

Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-se autoriteti kontraktor duhet të verifikojë këto elemente, duke u keshilluar me operatorin ekonomik në baze të informacionit të paraqitur. Nga interpretimi i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KVO gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si:

- rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilesinë e duhur;
- rreziku i terheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara;

- humbjat që mund të peshojnë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezultoi anomalisht e ulët.

Gjithashtu, theksojmë se referuar nenit 2 germa “b” “Qellimi” i ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”, parashikohet se; “Qellimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mireperdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”. Mireperdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave me të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit me të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe deshtimin e kontratës, që mund të vijne nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formule të perlllogaritjes të parashikuara në ligj.

Sa me sipër, referuar rastit në fjale dhe argumentave të paraqitura nga operatori ekonomik, gjykojmë se me dokumentet e dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik prane autoritetit kontraktor nuk përmbushen në mënyrë të detyrueshme kriter kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-se, si dhe mundësine për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përben shkak për deshtimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

Risiku i parë, nuk është provuar nga operatori ekonomik që nuk ka për të ndodhur dhe për këtë fakt nuk ka paraqitur ndonjë dokument/ vërtetime të leshuar nga autoritete kontraktore, që japin garanci pasi shërbimet dhe furnizimet e tij janë realizuar me sukses të plotë dhe në përputhje me kushtet kontraktuale.

Në rrethik, për rrezikun e dytë që ka të bëjë me tërheqjen e mundshme të operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës, KVO thekson se ky fakt mund dhe duhet të vërtetohet nga operatori ekonomik duke paraqitur minimalisht vërtetimin nga Agjencia e Prokurimit Publik ku ky operator nuk rezultoi të jetë sanksionuar për ndonjë shkelje të tillë.

Lidhur me argumentimin e kostos së lëndës së parë, transportit, makinerive, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion provues mjaftueshëm që vërteton koston e këtyre elementeve.

Gjithashtu, lidhur me vlerën e orës së punës të përcaktuar për artikujt perkates, konstatohet se vlera e orës së punës për artikujt perkates, është nën minimumin e lejuar nga pika 3 e VKM nr. 113, datë 1.3.2023 “Per Përcaktimin e Pages Minimale në Shkallë Vendi”, ku theksohet se paga baze minimale orare është 229.9 leke, gjithashtu duke zbritur edhe sigurimet shoqërore perkatesisht 9.5% të pages totale bruto përcaktuar në nenin 10 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Per Sigurimet Shoqërore Në Republikën E Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe sigurimet shëndetësore perkatesisht 1.7% referuar nenin 8 të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 “Per Sigurimin E Detyrueshëm Të Kujdesit Shëndetësor Në Republikën E Shqipërisë”, i ndryshuar, rezultoi se paga minimale neto është 229.9 leke për orë pune.

Nisur nga sa më sipër operatori ekonomik nuk ka argumentuar ofertën anomalisht të ulët, pasi asnjë element i kostos së perlllogaritjes prej operatorit nuk mjafton dhe as nuk vërteton koston e elementeve të ofertës të cilat nuk janë në përputhje me detyrimet që rrjedhin në fushën sociale dhe ajo e punës.

Bazuar në arsyetimin dhe faktet e paraqitura, gjykojmë se nga ana e operatorit ekonomik, oferta e të cilit në zbatim të formulës së përcaktuar në legjisllacion ka dalë anomalisht e ulët, nuk është arritur që të argumentohet, duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Rrjedhimisht gjykojmë, se nga ana e operatorit ekonomik nuk është paraqitur argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në përputhje me nenin 93 pika 2 të LPP-se, ndaj oferta e tij skualifikohet nga ana e KVO. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, KVO gjykon, se operatori ekonomik, nuk ka arritur që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Rrjedhimisht KVO gjykon se oferta e këtij operatori duhet të skualifikohet si ofertë anomalisht e ulët.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i suksesshëm:

1. “KLAME” shpk  
*Emri i plotë i shoqërisë*

NIPT: K21518003F  
*Numri i NIPT-it*

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 33, 944, 100 (tridhjetë e tre milion e nëntëqind e dyzetë e katër mijë e njëqind) lekë pa TVSH



*(e shprehur në shifra dhe në fjalë)*

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

Totali i pikëve të marra \_\_\_\_\_

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**